



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM  
Nr. 47 datë 31.07.2024**

**PËR  
“PËR STREHIMIN EMERGJENT TË ZJ. XH. B DHE FËMIJËVE TË MITUR NË  
NJËSITË E BANIMIT TEK BANESAT SOCIALE ME QIRA PRANË QENDRËS  
KOMUNITARE “PËR FAMILJEN” NR. 6 (ISH-KONVIKTI I SHKOLLËS PYJORE)”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 31.07.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 24 pika 2, të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenit 2, pika 25 të ligjit Nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar; pikës 19 të VKM - së Nr.384 datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore, VKB Nr. 27 datë 26.06.2022 “Për miratimin e Rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e Banesave Sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” Nr.6, VKB Nr.21 datë 29.04.2024 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira në administrimin e Bashkisë Shkodër”, Vendimit Nr.174 (3548), datë 24.07.2024 “Për Lëshimin e Urdhërit të Mbrojtjes”, së Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, si edhe dokumentacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë

**VENDOSI:**

1. Të miratojë strehimin emergjent të Zj.Xh.B në njësitë e banimit tek Banesat Sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” Nr.6 (Ish-Konvikti i Shkollës Pyjore).

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 01.08.2024



**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**